



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

THIRRJE PËR OFERTIM

Për: Kompani për transportim dhe montim

Titulli: Ofrimi i shërbimit për bartjen dhe montimin e ekspozitës “Dhuna nuk fshehet brenda mureve”

TERMAT E REFERENCËS

1. Informacione

Vizioni i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) parasheh një Kosovë ku gratë dhe burrat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta në arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, shëndetësi, dhe bëjnë një jetë pa dhunë. Misioni i RrGK është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, moshë, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. RrGK e realizon këtë mision përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve. Për periudhën 2021-2025, RrGK-ja është përkrahur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), në bashkëfinancim me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), për projektin katër vjeçar me titull “Avancimi i mëtejshmë i të drejtave të grave në Kosovë II”. Qëllimi kryesor i kësaj nisme është “Përmirësimi i barazisë gjinore në Kosovë, ku gratë dhe burrat janë më të barabartë dhe kanë më shumë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, shëndetësi, dhe për një jetë pa dhunë”. Pjesë e këtij projekti është edhe organizimi i fushatave për ngritje të vetëdijes së qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me dhunën në familje, të njoftohen me përgjegjësitë që institucione të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare kanë ndaj tyre dhe të informohen se ku mund të raportojnë dhunën. Poashtu, përmes kësaj ekspozite duam që qytetarët të informohen në mënyrë të detajuar se ku mund të kërkojnë ndihmë juridike falas si dhe ku mund të drejtohen nëse ata përballen me Dhunë në Baza Gjinore (DhBGj) apo dhunë në familje. Për ta arritur këtë, RrGK planifikon të mbajë ekspozitën “Dhuna nuk fshehet brenda mureve” në 12 qytete të Kosovës brenda vitit 2023 dhe 2024. Qytetet ku do të shpaloset kjo ekspozitë janë: Pejë, Mitrovicë, Shtime, Lipjan, Kaçanik, Vushtrri, Skenderaj, Rahovec, Suharekë, Podujevë, Gjilan dhe Prishtinë.

2. Qëllimi i projektit

Ndërgjegjësimi i publikut dhe i zyrtarëve mbi DhBGj dhe të drejtat e personave që kanë përjetuar dhunë është i rëndësishëm, duke përfshirë sigurimin që personat që kanë përjetuar DhBGj të mund të raportojnë dhunën dhe rastet e tyre të adresohen. Është e vështirë të zbatohet kuadri ligjor nëse njerëzit nuk paraqiten për të raportuar rastet. Për më tepër, rritja e ndërgjegjësimit është gjithashtu e rëndësishme për të transformuar normat sociale drejt reduktimit të DhBGj-së. Për këtë arsye, RrGK do të realizojë ekspozitën “Dhuna nuk fshehet brenda mureve”. Prandaj, qëllimi i përgjithshëm është që të bëhet bartja dhe monitimi i ekspozitës “Dhuna nuk fshehet brenda mureve”. Ekspozita do të bartet dhe montohet në katër qytete të Kosovës: Malishevë, Viti, Bresje-Fushë Kosovë dhe në Ferizaj. Kurse nisja do të bëhet nga Prishtina.

Për të kuptuar më shumë mbi strukturën e ekspozitës ju lusim ta shikoni këtë video duke klikuar këtu.

3. Afati për dorëzimin e ofertës tuaj*

Kontrata do të filloj nga data 10 maj 2023 deri më 31 dhjetor 2024. Orari i përafërt do të jetë si më poshtë:

Shpallja e tenderit 24 prill
Mbyllja e tenderit 12 maj
Dhënia e tenderit 18 maj
Takimi informues 19 maj
Ekspozita e parë 7 qershor 2023
Ekspozita e dytë 14 qershor 2023
Ekspozita e tretë 21 qershor 2023
Ekspozita e katërt 16 gusht 2023
Ekspozita e pestë 1 shtator 2023
Ekspozita e gjashtë 20 shtator 2023

Ndërsa, për vitin 2024, parashihen që të mbahen edhe gjashtë ekspozita të tjera, datat e të cilave do të caktohen në bashkëpunim me kompaninë transportuese.

4. Dorëzimi dhe vlerësimi i ofertave

Ju lutemi dorëzoni propozimin e detajuar dhe ofertën financiare deri më 12 maj 2023 në adresën info@womensnetwork.org me titull “Bartja dhe montimi i ekspozitës”.

Propozimet do të vlerësohen nga një komision bazuar në pajtueshmërinë me cilësinë dhe koston më të ulët.